

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, dhe Shoqëria Aksionare në pronësi private "ASNOVA HOLDING", me seli në rrugën Mikola Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, përmes personit të autorizuar Maja Pargovska, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 23.08.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, dhe Shoqëria Aksionare në pronësi private "ASNOVA HOLDING", me seli në rrugën Mikola Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, mbi Shoqërinë aksionare në pronësi private "SAV 92", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë., nëpërmjet shitblerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 19.06.2023, dhe e plotësuar më 31.07.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë dhe Shoqëria Aksionare në pronësi private "ASNOVA HOLDING", me seli në rrugën Mikola Krasnova nr. 27, Kiev, 03115,

Ukrainë, me të cilën ORBIKO SHPK për Tregti Zagreb dhe "ASNOVA HOLDING" do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë aksionare në pronësi private "SAV 92", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë., nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

ORBIKO SHPK për tregti Zagreb është një shoqëri e cila merret kryesisht me tregti me shumicë dhe njëkohësisht është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Kroacisë për një numër të madh të markave duke filluar nga produktet e kujdesit dhe bukurisë, produktet ushqimore dhe jo ushqimore, pajisjet teknike dhe elektrike, medikamentet, lodrat, tekstilet, cigaret, vajrat e motorit dhe shumë produkte të tjera tregtimi.

ORBIKO SHPK për tregti Zagreb ka një shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Shoqëria për tregti dhe shërbime ORBIKO SHPK Shkup, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Shkup. Objekti kryesor i operimit të ORBIKO SHPK Shkup është tregtia jo e specializuar me shumicë dhe në të njëjtën kohë është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një numër të madh të markave të produkteve të ushqimore, vajrave motorikë, baterive, parfume, ujë tualeti dhe deodorantë, kozmetikë dekorative, produkte për higjienën personale, produkte për kujdesin (fytyrë dhe trup), produkte higjienike shtëpiake.

Shoqëria Aksionare në pronësi private "**ASNOVA HOLDING**", është me objekt operimi - veprimtari të tjera financiare-shërbyese, përveç fondeve të sigurimit dhe pensioneve, që nuk përmenden diku tjetër.

Shoqëria aksionare në pronësi private "**SAV 92**", është me objekt operimi – Tregti me shumicë jo e specializuar.

Përpara zbatimit të përqendrimit, Shoqëria Aksionare në pronësi private "SAV 92" do të blejë 100% të kapitalit themelor të kompanive të mëposhtme në Ukrainë:

- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "BENICE", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, me objekt operimi – Shitje me shumicë jo e specializuar;
- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "SAVSERVICE-MOVA", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, me objekt operimi – Tregtia me shumicë jo e specializuar e ushqimeve, pijeve dhe produkteve të duhanit;
- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "PROMO SERVICE", me seli në rrugën Mikoli Krasnova nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, me objekt operimi – Agjencitë e marketingut;

Para përqendrimit, Shoqëria Aksionare në pronësi private "ASNOVA HOLDING" zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare private "SAV 92";

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски